



VENDIM

Nr. 11, Datë 11.04.2012

PËR MIRATIMIN E PUNONJËSVE TË FTUAR DHE ME KONTRATË TË PERSONELIT MËSIMORË DHE TË ADMINISTRATËS NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Senati Akademik i Universitetit të Arteve në mbledhjen e datës 11.04.2012, Pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe pas diskutimeve të anëtarëve dhe propozimeve përkatëse,

VËREN SE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9741, Datë 21.05.2007 " Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 95 e vijues të Statutit të Universitetit të Arteve, autoritetet drejtuese të njësive kryesore të Universitetit të Arteve, kanë paraqitur në Rektorat, numrin e personelit akademik të ftuar për vitin akademik 2011 -2012, si vijon:

1. Fakulteti i Muzikës , ka miratuar 188 (njëqind e tetëdhjetë e tetë) punonjës mësimor të ftuar.
2. Fakulteti i Artit Skenik, ka miratuar 59 (pesëdhjetë e nëntë) punonjës mësimor të ftuar.
3. Fakulteti i Arteve të Bukura, ka miratuar 24 (njëzetekatër) punonjës mësimor të ftuar.
4. Dega e Burimeve njerëzore për nevoja të Sektorëve të ndryshëm që Universiteti i Arteve ka gjatë vitit, ka propozuar 13 (trembëdhjetë) punonjës me kontratë.

Pra numri i përgjithshëm i personelit akademik të ftuar është **271** (dyqind e shtatëdhjetë e një).

Për sa më sipër, Senati Akademik i Universitetit të Arteve

VENDOSI

1. Numri i personelit akademik të ftuar dhe me kontratë si dhe të administratës, për vitin akademik 2011 - 2012 në Universitetin e Arteve është 271, persona, nga të cilët 188 në FM, 59 persona në FAS, 24 persona në FAB dhe 13 persona në administratë.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE